

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO-‘Dyqanet plot, xhepat bosh’/ Berisha: Pe - Syri Lajmi i fundit
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919183/video-dyqanet-plot-xhepat-bosh-berisha-pensionistet-nuk-blejne-dot-ilacet-regjimi-i-rames-po-shkaterron-shqiperine/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 17:00:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 16:35:32 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3a9914a95307b7a472ca7035c111b70df3eebffa1181af6666d75a3262e7ed802
TEKSTI	d1b9052ad2a57c9f5854136fc4924737436dd2ab72f00b5a78052d782aeb1f3a
PAMJA	4221f7b711432ba3f778016b32367a813ab228379f26c0e2ab48292eb761fd64

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1cf742bfc0157221f07314bac80e699d4ecaae638405b87296cf02113325802b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	96339b4c2dc892b32bb4ef058b3a026fd313b806f95d2de1cfb905f974369f65
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1cf742bfc0157221f07314bac80e699d4ecaae638405b87296cf02113325802b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**NDRIÇIM KULLA**

Dorëheqja urgjente e Edi Ramës nuk është më vetëm një kërkesë e opozitës, por edhe e ndërkombëtareve

**ENVER BYTYÇI**

Vendimi i Hagës dhe raporti ynë me të vërtetën!

LAJMI I FUNDIT**LIVE/ Foltorja e Ripërtëritjes me Kryetarin e PD-së, Sali Berisha, në Elbasan****më të lexuarat**

'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më



Mashtrimi me shëndetësinë falas: Shqipëria e dyta në Europë për koston e lartë



Akuzat ndaj shesës së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë



'Qeveria braktisi qytetarët përballë çmimeve', aktivisti: Shqipëria mban TVSH-në 20% për shportën bazë



Akuzat për shfeten e SHSH, Ndoja: Kjo është rënia e shtetit, është bashkuar me krimin



Fati i bashkëpunëtorëve kosovarë të Ramës



VIDEO-'Dyqanet plot, xhepat bosh'/ Berisha: Pensionistët nuk blejnë dot ilaçet, regjimi i Ramës po shkatërron Shqipërinë

18:35, 25/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, gjatë fjalës së tij në 'Foltoren e Ripërtëritjes' në Elbasan, është ndalur te gjendja ekonomike e pensionistëve dhe pamundësia e tyre, sipas tij, për të përballuar edhe shpenzimet bazë për ilaçe.

Ai tha se pensionistët, të cilët sipas tij kanë dhënë kontributin e tyre për vendin, sot përballen me vështirësi të mëdha ekonomike. 'Por sot pensionisti nuk bëhet fjalë të marrë dot ilaçet të cilat i duhen për sëmundjet më të zakonshme të moshës së tij', u shpreh kreu i PD-së.

Berisha e lidhi këtë situatë me atë që e konsideroi keqqeverisje të Edi Ramës, duke akuzuar regjimin e tij për varfërim, shpërpullim dhe dëmtim të vendit.

Pjesë nga fjala e kreu të PD, Sali Berisha:

Të dashur demokrate e demokratë, qytetare dhe qytetarë të Elbasanit, të pranishëm në këtë sallë, në qarkun e Elbasanit dhe kudo që ndodheni sonte, përshëndetjet e mia më të përzemërta, më vëllazërore, mirënjohjen më të pakufishme ndaj jush.

Të dashur deputetë të Partisë Demokratike, drejtues të Partisë Demokratike të Elbasanit, vlerësimin tim më të madh, respektin tim për përfaqësimin dinjitoz që ju i bëni këtij qyteti të bekuar dhe këtyre qytetarëve të mrekullueshëm.

Vëllazër e motra, zonja e zotërinj, jemi në një nga momentet ndoshta më të veçanta në historinë tonë kombëtare. Jemi në momentet e shpërbërjes së turpshme të një regjimi i cili qeveris këtë vend i bazuar çdo orë, çdo ditë në vjedhjen e qytetarëve shqiptarë, në krimin e organizuar, për zënien e tyre nga Elbasani dhe Shqipëria.

Në këtë aspekt, në këtë kuadër, në këtë shpërbërje, asgjë s'ka patur rol më përcaktues sesa guximi, qëndresa e juaj, dashuria juaj për Elbasanin dhe

Shqipëria në këto vite. Ju u përballët me këtë regjim që munda t'i veshi çdo epitet dhe që në fakt, në fakt e ka dëmtuar farën tonë, qenien tonë kombëtare, më shumë se çdo pushtues i të gjitha kohërave.

Nuk ka asnjë pushtues që kemi njohur ne, që në 10 vite të ketë përzënë kaq shqiptarë nga Shqipëria sa regjimi i Edi Ramës.

Për të matë, për të parë efektet shkatërrimtare të këtij regjimi mbi qenien tonë si popull, po ju jap sot vetëm një tregues. Sot në Elbasan dhe në Shqipëri, kemi atë numër lindësh që kishim 100 vite më parë, në kohë kur ishim më pak se 1 milion.

Pra, vjedhjet e tmerrshme të këtij regjimi, organizatat e krimit dhe droga e tij, kanë qenë shkatërrimtare për kombin tonë më shumë se gjithçka tjetër. Sot, jo në një, por në disa aspekte, qytetarët e Elbasanit dhe të Shqipërisë përballen po me atë varfëri që u përballën në periudhën e hiperkolektivizmit. Dallimi atëherë është ky: se atëherë dyqanet ishin bosh, nuk kishin ç'të blinin, kurse sot dyqanet janë plot por xhepat bosh.

Dhe nuk arrijnë dot pensionistët, të cilët janë jo pak po janë më shumë se një e treta e tyre që kanë shkruar jetën për të qenë ne këtu ku jemi, dhe ata, në mënyrë absolute, nuk blejnë dot ilaçet për mjekim. E kam thënë dhe një herë tjetër, po jua them dhe ju, kam qenë mjek, dhe një nga gjërat që më thërfe më shumë në shpiirt dhe në zemër, ishte momenti kur unë i çoja të sëmurit recetën kur bëhej gati me dal nga spitali.

E llogarisja me mendjen time mundësisht ilaçet më të lira të mundshme që ta përballonte. Por ai s'e merre recetën, sepse aty për aty më thoshte që: doktor, dita ime në punë në kooperativë është kaq, dhe unë me kaq mezi marr bukën, s'marr dot asgjë tjetër. Kurse sot, sot pensionisti nuk bëhet fjalë të marrë dot ilaçet të cilat i duhen për sëmundjet më të zakonshme të moshës së tij.

© SYRI.net

Lexo edhe:



118 ditë rezistencë popullore – Skandalet e reja, protestuesit kërkojnë dorëheqjen e Ramës dhe qeverisë së tij



'Ngjyra blu, ngjyra e shpresës'/ Alizoti: Rrënja e mirë prodhon risi të mirë! PD ka nevojë për qëndrueshmëri dhe të rinjtë



VIDEO/ Berisha: Shqipëria ngjan me një të sëmurë në urgjencë, kërkon ndërhyrje të menjëhershme

TË NGJASHME



'Të mos ketë derë të mbyllur për të rinjtë'/ Narazani: Ripërtëritja e PD ka nisur, Elbasani është dëshmia



VIDEO/ Berisha: Vezë mbi Padrinon në New York! Dënoj me forcë sharjet e Ramës ndaj diasporës



Shqipëria sot me Ramën, më e rrezikuar se në 1913, kur kërkohej copëtimi i saj!



'15 mijë euro nata në hotel'/ Ish-deputetja e PS: Rama harxhon 5 vite pension të një shqiptari në një natë



'Vlora Hyseni në krye të SHISH, jo rastësi', Paloka: Synonte marrëdhëniet Kosovë-Serbi-Shqipëri, favorizohej Vuçiç



S'ndalet mazhoranca/ Qeveria dërgon në Kuvend 'Territorialen', parashikohet shkrirja e 15 bashkive



Arbër Hitaj: U kalua vija e kuqe! Pas këtyre skandaleve Rama s'mund të jetë më kryeministër! T'i hapet rruga qeverisë teknike

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.